



ALGORITHM
WATCH



European Center for
Not-for-Profit Law




PANOPTYKON
FOUNDATION



Homo
Digitalis
Protect your rights



accessnow



Irish Council for
Civil Liberties



Elektronisk
Forpost
Norge



Dialogjet e BE-së: Ligji për inteligjencën artificiale duhet t'i mbrojtë të drejtat e njeriut

Deklarata e shoqërisë civile mbi të drejtat themelore në Ligjin e BE-së për inteligjencën artificiale

Ndërkohë që institucionet e Bashkimit Evropian¹ fillojnë me negociatat në dialogje, shoqëria civile u bën thirrje institucioneve të BE-së që të kontrollojnë nëse Rregullativa i vendos njerëzit dhe të drejtat themelore në vend të parë në Ligjin për inteligjencën artificiale (Ligji për IA-në).

Në Evropë dhe në mbarë botën, sistemet me IA-në përdoren që të na ndjekin dhe të na kontrollojnë në vendet publike, të parashikojnë sa gjasa kemi për të kryer vepra kriminale në të ardhmen, ta lehtësojnë mënyrën e shkeljes së të drejtës për të kërkuar azil, t'i parashikojnë emocionet tona, të na kategorizojnë dhe të miratojnë vendime kryesore që do të përcaktojnë qasjen tonë në shërbimet publike, mbrojtjen sociale, arsimin dhe punësimin.

Pa rregullim më të rreptë, kompanitë dhe qeveritë do të vazhdojnë t'i përdorin sistemet me IA-në që e përkeqësojnë mbikëqyrjen masive, diskriminimin strukturor, fuqinë e centralizuar të kompanive të mëdha teknologjike, miratimin e papërgjegjshëm të vendimeve publike dhe

¹Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Komisioni Evropian kanë nisur negociatat ndër-institucionale, "dialogjet", për të arritur marrëveshje të përkohshme për propozimin legjislativ që do të jetë i pranueshëm, si për Parlamentin, ashtu edhe për Këshillin.

shkaktimin e dëmit në mjedisin jetësor.

U bëjmë thirrje institucioneve të BE-së të kontrollojnë nëse zhvillimi dhe përdorimi i IA-së janë të përgjegjshëm, transparentë ndaj publikut dhe nëse njerëzit janë të motivuar për t'i kundërshtuar dëmet:

1. Inkurajoni njerëzit e interesuar me kornizë të llogaridhënies, transparencës, qasjes dhe mjetit juridik

Me rëndësi të jashtëzakonshme është Ligji i BE-së për IA-në t'i inkurajojë njerëzit dhe faktorët që kanë interes publik të kuptojnë, të njohin, të kontestojnë dhe të kërkojnë mjet juridik në situatat kur sistemet me IA-në i përkeqësojnë dëmet dhe i shkelin të drejtat themelore. Për këtë qëllim, është thelbësore që Ligji për IA-në të hartojë kornizë për llogaridhënie, transparencë, qasje dhe mjet juridik. Në kornizë duhet të bëhet kjo si në vijim:

- Detyrimi për të gjithë "përdoruesit" (zbatuesit) publikë dhe privatë që të kryejnë dhe të publikojnë [vlerësimin e ndikimit të të drejtave themelore](#) përpara përdorimit të çdo sistemi me IA-në me rrezik të lartë dhe përfshirjes aktive të shoqërisë civile dhe njerëzve të interesuar në këtë proces;
- Kërkimi i të gjithë përdoruesve të sistemeve me IA-në me rrezik të lartë dhe përdoruesve të të gjitha sistemeve në botën publike [të theksojnë se do t'i përdorin ato sisteme në bazën e të dhënave të BE-së që është e dukshme për publikun](#) përpara përdorimit;
- Të kujdeset që ofruesit e shërbimeve me IA-në me seli në BE, sistemet e të cilëve ndikojnë mbi njerëzit jashtë BE-së, u nënshtrohen të njëjtave kërkesa si ata që janë brenda BE-së.
- Të mundësojë [kërkesa horizontale dhe të integruara për qasje](#) për të gjitha sistemet me IA-në;
- Të sigurohet që njerëzit e interesuar nga sistemet për IA-në [janë të njoftuar dhe kanë të drejtën të kërkojnë informacione](#) në situatat kur ndikohen nga vendimet dhe rezultatet që dalin nga përdorimi i IA-së;
- Të përfshihet e drejta e njerëzve të interesuar [të parashtrijnë ankesë në autoritetet nacionale](#) nëse të drejtat e tyre shkelen kur përdorin ndonjë sistem me IA-në;
- Të përfshijë të drejtën për të përfaqësuar personat fizikë dhe të drejtën e organizatave që kanë interes publik [të parashtrijnë ankesa të pavarura](#) në trupat mbikëqyrës nacionalë;
- Të përfshijë [të drejtën e mjeteve juridike efikase](#) për shkeljen e të drejtave.

2. Vendosni kufij për mbikëqyrjen e dëmshme dhe diskriminuese nga organet nacionale të sigurisë, të zbatimit të ligjit dhe të

migracionit

Sistemet me IA-në po zhvillohen dhe përdoren gjithnjë e më shumë në format e dëmshme dhe diskriminuese të mbikëqyrjes shtetërore. Sistemet e tilla përfshijnë në mënyrë disproporcionale komunitetet tashmë të marginalizuara, i minojnë të drejtat ligjore dhe procedurale dhe kontribuojnë në mbikëqyrjen masive. Kur sistemet me IA-në përdoren në kontekstin e zbatimit të ligjit, sigurisë dhe kontrollimit të migracionit, ekziston rrezik edhe më i madh për të shkaktuar dëm dhe për të shkelur të drejtat themelore dhe sundimin e së drejtës. Për të zbatuar mbikëqyrjen publike dhe për të parandaluar dëmin, në Ligjin e BE-së për IA-në duhet të ketë:

- Ndalim të plotë [për të zbatuar identifikimin biometrik në distancë në kohë reale dhe në retrospektivë](#) në vende ku ka qasje publikisht nga të gjithë faktorët, pa përjashtim;
- Ndalim për të gjitha format e [sistemeve të parashikimit dhe profilimit](#) në zbatimin e ligjit dhe të drejtën penale (duke i përfshirë sistemet që fokusohen dhe i përfshijnë individët, grupet dhe lokacionet ose zonat);
- Ndalime për [IA-në në kontekst të migracionit](#) për të kryer vlerësime individuale të rreziqeve dhe profileve në bazë të të dhënave personale dhe të ndjeshme dhe sistemeve analitike prediktive të përdorura për të ndaluar, kufizuar dhe parandaluar migracionin;
- Ndalim për [sistemet e kategorizimit biometrik](#) që i kategorizojnë personat fizikë në bazë të karakteristikave të ndjeshme dhe të mbrojtura, si dhe duke përdorur çdo kategorizim biometrik dhe sisteme të automatizuara të njohjes së sjelljes në vendet ku ka qasje publikisht;
- Ndalim për përdorimin [e sistemeve për njohjen e emocioneve](#) për të nxjerrë konkluzione lidhur me emocionet dhe gjendjen mentale të njerëzve;
- Refuzim të shtesës së Këshillit që paraqet përjashtim të përgjithshëm të Ligjit për IA-në lidhur me sistemet me IA-në që zhvillohen ose përdoren për qëllimet e sigurisë nacionale;
- Mënjanim të përjashtimeve dhe zbrazëtirave në ligj për zbatimin e ligjit dhe kontrollimin e migracionit të propozuar nga Këshilli;
- Mundësim të transparencës për publikun për atë se kur, si dhe për çfarë faktorët publikë përdorin IA-në me rrezik të lartë në fushën e zbatimit të ligjit dhe kontrollimit të migracionit, si dhe shmangien e përjashtimeve nga detyrimi për të futur përdorime me rrezik të lartë në bazën e të dhënave të IA-së së BE-së.

3. Reagoni lobimit të kompanive të mëdha teknologjike: mënjanoni zbrazëtirat në ligj që i minojnë rregullat

Ligji i BE-së për IA-në duhet të përcaktojë standarde të qarta dhe të besueshme juridikisht për zbatim, me qëllim që të zbatohet në mënyrë efektive legjislativi. Legjislativi duhet t'i përmbahet procesit objektiv për të përcaktuar se cilat sisteme janë me rrezik të lartë dhe t'i mënjanojë të gjitha "shtresat plotësuese" që i shtohen procesit të klasifikimit të rreziqeve të larta. Shtresa e tillë do t'u mundësonte personave që e zhvillojnë IA-në, pa llogaridhënie ose mbikëqyrje, të vendosin nëse sistemet e tyre paraqesin rrezik mjaft "të rëndësishëm" për të garantuar mbikëqyrje juridike në pajtim me Rregulloren. Procesi diskrecional i klasifikimit të rreziqeve rrezikon të minojë të gjithë Ligjin për IA-në, duke e çuar atë drejt vetërregullimit, duke paraqitur sfida të pakapërcyeshme për zbatimin dhe harmonizimin, dhe duke inkurajuar kompanitë e mëdha që të zvogëlojnë klasifikimin e sistemeve të tyre me IA-në.

Negociatorët e Ligjit për IA-në nuk duhet të lëshojnë përpara lobimeve të kompanive të mëdha teknologjike që përpiqen t'i anashkalojnë rregullat me interes financiar. Ligji për IA-në duhet:

- ta mënjanojë shtresën plotësuese të shtuar në procesin e klasifikimit të rrezikut në nenin 6 dhe ta kthejë procesin e qartë dhe objektiv të klasifikimit të rrezikut të theksuar në qëndrimin origjinal të Komisionit Evropian;
- të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të sistemeve me IA-në për qëllim të përgjithshëm kanë detyrime të qarta në pajtim me Ligjin për IA-në dhe mos të lejojnë që ofruesit dhe përdoruesit e vegjël të mbajnë barrën e detyrimeve që duhet të mbajnë personat që fillimisht i kanë zhvilluar sistemet.

Përgatitën:

1. European Digital Rights (EDRi)
2. Access Now
3. Algorithm Watch
4. Amnesty International
5. Bits of Freedom
6. Electronic Frontier Norway (EFN)
7. European Center for Not-for-Profit Law, (ECNL)
8. European Disability Forum (EDF)
9. Fair Trials
10. Homo Digitalis
11. Irish Council for Civil Liberties (ICCL)
12. Panoptikon Foundation
13. Platform for International Cooperation on the Rights of Undocumented Migrants (PICUM)

Nënshkruan:

- 14.7amleh-The Arab Center for the Advancement of Social Media
15. Academia Ciudadã - Citizenship Academy
16. Africa Solidarity Centre Ireland
- 17.AlgoRace
18. Algorights
19. All Faiths and None
- 20.All Out
- 21.Anna Henga
- 22.Anticorruption Center
23. ARSIS - Association of the Social Support of Youth
24. ARTICLE 19
25. Asia Indigenous Peoples Pact
- 26.Asociación Por Ti Mujer
- 27.Aspiration
28. Association for Juridical Studies on Immigration (ASGI)
29. Association Konekt
- 30.ASTI asbl - Luxembourg
- 31.AsyLex
- 32.Austria human rights League
- 33.Avaaz
34. Balkan Civil Society Development Network
35. Bulgarian center for Not-for-Profit Law (BCNL)
36. Bürgerrechte & Polizei/CILIP, Germany
37. Canadian Civil Liberties Association
38. Chaos Computer Club
- 39.Charity & Security Network
- 40.Citizen D / Državljan D
- 41.Civil Liberties Union for Europe
- 42.Civil Society Advocates
43. Coalizione Italiana Libertà e Diritti civili
44. Comisión General Justicia y Paz de España
45. Comisión Legal Sol
- 46.Commission Justice et Paix Luxembourg
- 47.Controle Alt Delete
48. Corporate Europe Observatory (CEO)
49. D64 - Zentrum für digitalen Fortschritt
50. DanChurchAid (DCA)
51. Danes je nov dan, Inštitut za druga vprašanja
52. Data Privacy Brasil
- 53.Defend Democracy
- 54.Democracy Development Foundation
- 55.Digital Security Lab Ukraine
- 56.Digital Society, Switzerland
- 57.Digitalcourage
- 58.Digitale Gesellschaft
- 59.Digitalfems
60. Diotima Centre for Gender Rights & Equality
61. Donestech

62. epicenter.works - for digital rights
63. Equinox Initiative for Racial Justice
64. Estonian Human Rights Centre
65. Eticas
66. EuroMed Rights
67. European Anti-Poverty Network (EAPN)
68. European Center for Human Rights
69. European Civic Forum
70. European Movement Italy
71. European Network Against Racism (ENAR)
72. European Network on Statelessness
73. European Sex Workers Rights Alliance (ESWA)
74. Fair Vote
75. FEANTSA, European Federation of National Organisations Working with the Homeless
76. Free Press Unlimited
77. Fundación Secretariado Gitano
78. Gong
79. Greek Forum of Migrants
80. Greek Forum of Refugees
81. Health Action International
82. Hiperderecho
83. Homo Digitalis
84. horizontl Collaborative
85. Human Rights Watch
86. I Have Rights
87. IDAY-Liberia Coalition Inc.
88. ILGA-Europe (the European region of the International Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex Association)
89. info.nodes
90. Initiative Center to Support Social Action "Ednannia"
91. Institute for Strategic Dialogue (ISD)
92. International Commission of Jurists
93. International Rehabilitation Council for Torture victims
94. IT-Pol
95. Ivorian Community of Greece
96. Kif Kif vzw
97. KOK - German NGO Network against Trafficking in Human Beings
98. KontraS
99. Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)
100. La Strada International
101. Lafede.cat
102. LDH (Ligue des droits de l'Homme)
103. Legal Centre Lesbos
104. Liberty
105. Ligali / IDPAD (Hackney)
106. Ligue des droits humains, Belgium
107. LOAD e.V.
108. Maison de l'Europe de Paris
109. Metamorphosis Foundation
110. Migrant Tales
111. Migration Tech Monitor
112. Mnemonic
113. Mobile Info Team
114. Moje Państwo Foundation
115. Moomken organization for Awareness and Media

- | | | | |
|------|---|------|---|
| 116. | National Campaign for Sustainable Development Nepal | 134. | Refugee Law Lab, York University |
| 117. | National Network for Civil Society (BBE) | 135. | REPONGAC |
| 118. | National old folks of Liberia.com | 136. | SHARE Foundation |
| 119. | Novact | 137. | SOLIDAR & SOLIDAR Foundation |
| 120. | Observatorio Trabajo, Algoritmo y Sociedad | 138. | Statewatch |
| 121. | Open Knowledge Foundation Germany | 139. | Stichting LOS |
| 122. | Partners Albania for Change and Development | 140. | Superbloom (previously known as Simply Secure) |
| 123. | Politiscope | 141. | SUPERRR Lab |
| 124. | Privacy First | 142. | SwitchMED - Maghweb |
| 125. | Privacy International | 143. | Symbiosis - Council of Europe School of Political Studies in Greece |
| 126. | Privacy Network | 144. | TAMPEP European Network for the Promotion of Rights and Health among Migrant Sex Workers. |
| 127. | Promo-LEX Association | 145. | TEDIC - Paraguay |
| 128. | Prostitution Information Center (PIC) | 146. | The Border Violence Monitoring Network |
| 129. | Protection International | 147. | The Good Lobby |
| 130. | Public Institution Roma Community Centre | 148. | Transparency International |
| 131. | Racism and Technology Center | 149. | Volonteuope |
| 132. | Red en Defensa de los Derechos Digitales | 150. | WeMove Europe |
| 133. | Red Española de Inmigración y Ayuda al Refugiado | 151. | Xnet |